KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
Nr.07/351/01-9577
Dt.05.05.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative e Komunës së Gjakovës**, përmes Kryetares së Komunës së Gjakovës, për dhënien e Lejes së Ndërtimit për renovimin e objektit ekzistues të Kuvendit të Komunës dhe ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë - Aneksi i objektit të Kuvendit të Komunës, me etazhitet B+P+5, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 02/L-28 nenit 11, bien këtë:

A K T V E N D I M

I. I LEJOHET: Aplikuesit: Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative e Komunës së Gjakovës, Renovimi i objektit ekzistues të Kuvendit të Komunës dhe ndërtimi i objektit të kategorisë së dytë me destinim "Aneksi i Objektit të Kuvendit të Komunës së Gjakovës", sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Zhvillimor Urban, në ngastrat kadastrale ndërtimore me nr. 5794/0, dhe 5794-0-235-0, ZK: Gjakovë - Qytet, në pronësi të PSH "Kuvendi i Komunës" Gjakovë, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e aneksit të objektit të cekur si më lartë, etazhiteti i objektit ekzistues është B+P+4, në sipërfaqe të përgjithshme (bruto) te objektit ekzistues për renovim $S = 3.030.9 \text{ m}^2$, ndërsa etazhiteti i aneksit të objektit për ndërtim është B+P+5, me sipërfaqja e përgjithshme (bruto) e aneksit të objektit të Kuvendit të Komunës për ndërtim: $S=3524 \text{ m}^2$.

Sipërfaqja e objektit të ri të Aneksit të Kuvendit:

Bodrumi:	(Sip,Bruto):	$S=988.7 \text{ m}^2$
Perdhesa:	(Sip,Bruto):	$S=400.9 \text{ m}^2$
Kati i parë:	(Sip,Bruto):	$S=421.7 \text{ m}^2$
Kati i dytë:	(Sip,Bruto):	$S=421.7 \text{ m}^2$
Kati i tretë:	(Sip,Bruto):	$S=421.7 \text{ m}^2$
Kati i katër:	(Sip,Bruto):	$S=421.7 \text{ m}^2$
Kati i pestë:	(Sip,Bruto):	$S=447.6 \text{ m}^2$

II. Hartimin e projektit me destinim: renovimi i objektit ekzistues të Kuvendit të Komunës së Gjakovës dhe ndërtimi i aneksit të objektit të kuvendit, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë kompania konsulence "Eptisa" me zyre regjionale për Shqipëri dhe Kosovë në Prishtinë.

III. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik i cili është punuar bazuar në dokumentacionin e prezantuar, i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

IV. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar original të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë për Punë Inspektuese, për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit të lokacionit të piketuar.
- Për Objektet e kategorisë së dytë, Investitori duhet që për secilën fazë të ndërtimit, të parashtrrojë kërkesë, pranë Drejtorisë për Punë Inspektuese, me qëllim të Inspektimit dhe përcjelljes së realizimit të punimeve nga secila fazë, si dhe kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm për lëshimin e Certifikatës - Lejes së Përdorimit të objektit.

V. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative e Komunës së Gjakovës, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM-së, me nr. 07/351/01-9577, të datës 25.04.2017 për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për renovimin e objektit ekzistues të Kuvendit të Komunës dhe ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë - Aneksi i objektit të Kuvendit të Komunës, me etazhitet B+P+5, në ngastrën kadastrale ndërtimore me nr. 5794/0, ZK: Gjakovë - Qytet, në pronësi të PSH "Kuvendi i Komunës" Gjakovë, siç është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi, **Investimi i të cilit është donacion i fituar nga Bashkimi Evropian "IPA 2014 PROGRAMI PËR KOSOVËN"** dhe realizohet në partneritet me Komunën e Gjakovës.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500, të datës 09.03.2017, i vërtetuar nga DUMM-Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 03.05.2017, në pronësi të PSH "KUVENDI I KOMUNËS -GJAKOVË", lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Çertifikatën mbi të drejtën në pronë e paluajtshme(fotokopje) me nr. të lëndëve 2174-2/16 dt.03.05.2017, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Raportin mbi punimet gjeomekanike hulumtuese dhe kërkimet laboratorike në lokacionin e parashikuar për ndërtimin e Aneksit të objektit të K.K.Gjakovë, i hartuar nga kompania konsulence "Eptisa" Prishtinë.
5. Raportin e ndikimit në mjedis të punuar nga "Eptisa", me seli në Prishtinë.
6. Pëlqimin Sanitar me nr.14/530/01-10424, dt.04.05.2017, nga Inspektorjati Sanitar Komunal- Drejtoria e për Punë Inspektuese e Komunës së Gjakovës.
7. Pëlqimin për lokacion nga mbrojtje kundër zjarrit, me nr.06/17, me datë 04.05.2017, lëshuar nga Sektori i parandalimit dhe hulumtimit të zjarrit - Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim e Komunës së Gjakovës.
8. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, dt. 28.04.2017.
9. Pëlqimin nga K.R.U."Radoniqi"Sh.A.-Gjakovë, të datës 28.04.2017.
10. Pëlqimin nga PTK -Vala, me nr. 22, dt.02.05.2017.
11. Pëlqimin nga Ngrohtorja e Qytetit SH.A.me nr.226, dt.02.05.2017.
12. Pëlqimin nga Ipko Telecommunications, të datës 03.05.2017,
13. Përgjigjen nga Fiberlink, të datës 02.05.2017, e protokolluar me nr 07-016/01-10297, dt.02.05.2017.
14. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, i punuar nga kompania konsulce "Eptisa" me zyre regjionale për Shqipëri dhe Kosovë në Prishtinë.

I liruar nga taksa administrative, në bazë Nenit 5, paragrafi 5.15. nën paragrafi b), të Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa nga Shërbimet Komunale, me nr. 01 Nr.011-43964/2015, dt.30.-6.2015.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative.
- Drejtorisë për Punë Inspektuese,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arhives.

Zyrtar i lartë për çështje juridike


Zenel Shabani, jur. I dipl.


U.D. Drejtori
Elida Bejtullahu, inxh.e dipl.e ark.

K.K. GJAKOVË

Z.K. :Gj.Qytet

Ng. nr. 1794-0, 1795-0, 1796-0, 1797 dhe 1798-0.


PLAN SITUACIONI

**Lokacioni: KUVENDI I KOMUNËS-
RENOVIMI I OBJEKTIT EKZISTUES
DHE ANEKSI I OBJEKTIT TË RI**

Gjakovë, 05.05.2017

punoi: Fatmir Bobi, tek.gjeod.

vërtetoi: Agron Gojani, i.d.a.





Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : GJAKOVË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Gjakovë-qytet

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m2
P-70705029-05794-0	Pracelë / Parcela / Parcel	1572,0



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1000

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 03.05.2017

Koha/ Vreme/ Time: 08:08:56

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:

Apróvot/Úsvojio/Aproved: MCO GJAKOVË director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture: